



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA RREGULLATORE
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 19242 prot.

Vlorë, më 17.11 2025

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ . 2025

PËR

**MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA
PËRMBYTJA E BANESËS TË Z.ËNGJËLL MEHMETAJ DHE SHPËRBLIMIN
FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLORË.**

Këshilli i Bashkisë Vlorë në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, neni 9/1 pika b, neni 29/1, neni 54 pika dh ,të ligjit nr.45/2019 datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”,në VKM Nr. 329 data 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” paragrafi III/ë, pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Financës dhe Këshilli i Qarkut Vlorë,

VENDOSI:

1. Të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga përmbytja në banesën e z.Ëngjëll Mehmetaj, e ndodhur në fshatin Xhyherinë, Njësia Administrative Qëndër, Bashkia Vlorë, në datën 17.06.2025, sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë përkatësisht në masën:

A. 9.190(nëntë mijë e njëqind e nëntëdhjetë) lekë për punime ndërtimi (18.380x50%).

B. 144.885 (njëqind e dyzetë e katër mijë e tetëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë për mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake.

2. Shpërblimi financiar do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile të Bashkisë Vlorë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile pranë Bashkisë Vlorë.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015, neni 55 pika .

KRYETAR

Elis Halili





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA RREGULLATORE
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. _____ prot.

Vlorë, më _____ 2025

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN “MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA PËRMBYTJA NË BANESËN E Z.ËNGJËLL MEHMETAJ DHE SHPËRBLIMI FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLORË “

Në zbatim të VKM Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, në Bashkinë Vlorë datë 16.06.2025 ka paraqitur kërkesën z.Ëngjëll Mehmetaj me nr.9402prot. për shkak të përmbytjes së banesës nga çarja e kanalit vaditës në datën 06.06.2024 e ndodhur në fshatin Xhyherinë, Njësia Administrative Qëndër, Bashkia Vlorë.

Komisioni i Bashkisë Vlorë i ngritur me Urdhërin e Brendshëm Nr.26 datë 24.01.2025 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, shkoi në banesë për të konstatuar dëmet e shkaktuara nga përmbytja e banesës.

Mbas hartimit të procesverbalit të konstatimit të gjendjes së banesës në datë 17.06.2025, është vijuar me shkresën përcjellëse me Nr.9402/1 prot, datë 15.09.2025 “Dërgohet dokumentacioni për banesën e përmbytur të z.Ëngjëll Mehmetaj në Këshillin e Qarkut Vlorë për të vazhduar me preventivat e vlerësimit të dëmeve nga komisioni i ekspertëve.

Këshilli i Qarkut Vlorë me shkresën Nr.8919/2 prot, datë 05.11.2025 “Dërgim dokumentacioni për banesën e përmbytur të z.Ëngjëll Mehmetaj”, ka dërguar preventivin e hartuar nga komisioni i ekspertëve, nga ku rezulton:

- Vlera e dëmeve në banesën e z.Ëngjëll Mehmetaj është 154.075 (njëqind e pesëdhjet e katër mijë e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

Aktualisht Bashkia Vlorë ka mundësi financiare për të ndihmuar familjet për banesat e dëmtuara. Për sa më lart i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga përmbytja në banesën e z.Ëngjëll Mehmetaj sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë dhe shpërblimin financiar i cili do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile të Bashkisë Vlorë.

DREJTOR

Jurian Mina

